

VENDIM
Nr. 969, datë 2.12.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË ZGJEDHJES SI
DHE KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË TIJ**

(Ndryshuar me VKM nr. 598, datë 15.10.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes *si dhe kompensimit të shpenzimeve* së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë (në vijim KKR), si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

2. KKR-ja përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët, jo më pak se 6 (gjashtë) i përkasin secilës gjini. Anëtarët e KKR-së janë, si më poshtë vijon:

- a) ministri përgjegjës për rininë, bashkëkryetar;
- b) titullari i Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR);
- c) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- ç) 4 (katër) përfaqësues nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë;
- d) 4 (katër) përfaqësues të këshillave studentorë;
- dh) 2 (dy) përfaqësues të parlamentit të nxënësve;
- e) 2 (dy) përfaqësues nga komuniteti shqiptar në diasporë;
- ë) 1 (një) përfaqësues nga pakicat kombëtare rome ose egjiptiane;
- f) 1 (një) përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara;
- g) 1 (një) përfaqësues nga komuniteti LGBTI+.

2/1. Bashkëkryetari i KKR-së zgjidhet nëpërmjet votimit nga anëtarët jopërfaqësues të institucioneve shtetërore, në mbledhjen e parë të KKR-së.

3. Mandati i anëtarëve të KKR-së është dyvjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Anëtari i KKR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrat të ndryshimit.

5. Anëtarët e KKR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Anëtarët e KKR-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës e gjithëpërfshirjes.

6/1. Kandidati për anëtar i KKR-së duhet të jetë shtetas shqiptar dhe t'i përkasë grup-moshës rinore, të përcaktuar në shkronjën “P”, të nenit 3, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar.

7. Kandidati për anëtar i KKR-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriterë:

a) të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 (dy) vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve për promovimin e të rinjve;

b) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

8. Kandidati për anëtar i KKR-së, jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriterë:

- a) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) të ketë përvojë pune në fushën e zhvillimit apo të zbatimit të aktiviteteve rinore, apo të ketë qenë pjesë e nismave ose aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
- c) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi;
- ç) *të jetë në detyrë pranë strukturës së përfaqësuar gjatë periudhës së thirrjes dhe votimit të kandidatëve, për kandidatin e përmendur në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi.*

9. Kandidati, për t’u emëruar anëtar i KKR-së, duhet të paraqesë, përkatësisht, dokumentacionin si vijon:

- a) kandidati, përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:
 - i. kërkesën;
 - ii. jetëshkrimin;
 - iii. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
 - iv. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - v. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.
- b) kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
 - i. kërkesën;
 - ii. jetëshkrimin;
 - iii. fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin;
 - iv. vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
 - v. letër motivimi;
 - vi. vetëdeklarimin e konfliktit të interesit;
- vii. *letër mbështetjeje e lëshuar nga një shoqatë shqiptare në diasporë për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij vendimi;*
- viii. *letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicës kombëtare përkatëse, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij vendimi;*
- ix. *letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “f”, të pikës 2, të këtij vendimi;*
- x. *letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTI+, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “g”, të pikës 2, të këtij vendimi.*

10. Thirrja për kandidatët jopërfaqësues të institucioneve shtetërore, publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare për Rininë (AKR) për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Votimi përzgjedhës për kandidatët e përmendur në shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi kryhet në formë elektronike në faqen zyrtare të AKR-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e fillimit të procesit të votimit.

10/1. *Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve të përmendur në shkronjat “e”, “ë”, “f” e “g”, të pikës 2, të këtij vendimi, bëhet nga një komision vlerësimi, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar nga ministri përgjegjës për rininë, të përzgjedhur, si më poshtë vijon:*

- a) 1 (një) anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë, në rolin e kryetarit të komisionit;
- b) 1 (një) anëtar i caktuar nga titullari i Agjencisë Kombëtare për Rininë (AKR);
- c) 1 (një) anëtar në detyrë i KKR-së, përfaqësues i të rinjve, që nuk rikandidon në thirrje.

10/2. *Vlerësimi maksimal për dokumentacionin e kandidatëve të përmendur në shkronjat “e”, “ë”, “f” e “g”, të pikës 2, të këtij vendimi, është 40 (dyzet) pikë dhe përcaktohet, si më poshtë vijon:*

- a) *Propozimi i një politike rinore vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;*
- b) *Jetëshkrimi vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;*
- c) *Angazhimi në çështjet e rinisë vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;*
- ç) *Angazhimi në çështjet e komunitetit që përfaqëson vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.*

10/3. *Ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare për Rininë bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe*

përfshirjen sociale për promovimin e thirrjes për kandidim në KKR dhe për verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve, kur është e nevojshme.

11. KKR-ja mbledhet jo më pak se 2 (dy) herë në vit. Mbledhjet thirren e drejtohen nga kryetari. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KKR-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen.

12. Mbledhja e KKR-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.

13. KKR-ja mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga tre anëtarë. Caktimi i anëtarëve të sekretariatit teknik e procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KKR-së përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për rininë.

14. Në çdo mbledhje të KKR-së mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KKR-së.

15. Mandati i anëtarit të KKR-së mbaron kur:

a) përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
b) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykatë apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) jep dorëheqjen.

16. Anëtari i Këshillit Kombëtar të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga ministri përgjegjës për rininë, në rastet kur:

a) nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KKR-së;

b) paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

c) nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKR-së;

ç) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKR-së.

17. Anëtari i KKR-së, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga ministri përgjegjës për rininë me një kandidat që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

18. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.

19. Ngarkohet Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore t'i propozojë ministrit përgjegjës për rininë *anëtarin* e tyre përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Rinisë.

19/1. Anëtari i KKR-së nuk shpërblehet për kontributin e dhënë në KKR. Shpenzimet e bëra në kuadër të veprimtarisë së KKR-së mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR).

19/2. Anëtarit të KKR-së, jopërfaqësues të institucioneve shtetërore, që merr pjesë në mbledhjen e KKR-së, i mbulohen shpenzimet e mëposhtme:

a) dietë ditore në masën 500 (pesëqind) lekë, në rastin kur banon në një largësi prej 50–100 km nga vendi i organizimit të mbledhjes;

b) dietë ditore në masën 1000 (një mijë) lekë, në rastin kur banon në një largësi mbi 100 km nga vendi i organizimit të mbledhjes;

c) shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, e miratuar në vendimin nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus".

20. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe